



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KOMISIONI STAUTAR PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E STATUTIT TE KOMUNËS SË PODUJEVËS

Mbështetur në dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2023 Për Administratë të Hapur në Komunë (me theks nenin 23), në dispozitat e Rregullores nr.prot.01-016/01-0044979/25 për Transparencë në Komunën e Podujevës (me theks nenet 19 dhe 22), duke vepruar sipas autorizimeve të dhëna me Vendimin e Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/04-0044925/26 për themelimin e Komisionit Statutar për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës së Podujevës, merr këtë;

V E N D I M PËR VËNIE NË KONSULTIM PUBLIK

Neni 1

Vëhet në konsultim publik: **Draft Statuti për Plotësimin dhe Ndryshimin e Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 datë 26.06.2018**

Neni 2

Konsultimi publik sipas këtij Vendimi, zgjat 15 ditë përkatësisht prej datës, **20.08.2026 deri më 03.09.2026**, brenda së cilës Komisioni Statutar mund të organizoj debate / konsultime të ndryshme publike, kurse debati i përgjithshëm publik me qytetarë mbahet më **31.08.2026**, duke filluar nga **ora 13;15** në ndërtesën e Komunës, kati përdhës - salla e mbledhjeve.

Neni 3

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten gjatë periudhës së konsultimit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së konsultimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e Komunës zyra nr.54, si dhe në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; liridona.rrahmani@rks-gov.net; të cilat pastaj përcjellën te Kryesuesi i Komisionit Statutar, brenda periudhës së diskutimit/konsultimit publik.

Neni 4

Dokumenti sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i njëjti publikohet në ueb-faqen zyrtare të Komunës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (rubrika; aktet për diskutim publik), në Platformën Qendrore të Konsultimeve Publike, si dhe aty ku Komisioni e vlerëson të nevojshme.

Neni 5

Konsultimi / debati publik zbatohet nga **Komision Statutar për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës së Podujevës**, në bashkëpunim dhe koordinim me Zyrtaren përgjegjëse për konsultime publike, që përkujdesen për përgatitjen e procesverbaleve & raportit nga konsultimi dhe debati publik si dhe të japin sqarime për arsyeshmërinë e pranimi ose mospranimi të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.Prot.01-016/01-0050698/26
Podujevë, datë; 19 gusht 2026

Kryesuesi i Komisionit
Isak Shabani